



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 113 Prot

Tiranë, më 30, 08, 2013

VENDIM QARKULLUES Nr. 264, datë 30, 08, 2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentralit Malla, komuna Zall Reç (Qarku Dibër) mbi bazën e kërkesës së Subjektit "GJURR REÇ" sh.p.k., Dibër,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentralit Malla, komuna Zall Reç (Qarku Dibër), paraqitur nga Subjekti "GJURR REÇ" sh.p.k., Dibër.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Dibër bazuar në kontratën dypalëshe midis "GJURR REÇ" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("GJURR REÇ" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

VISAR ZHITI
MINISTËR

SEKRETAR I KKA
ROLAND OLLI

